

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën zhvilloi mbledhjen e dytë

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës për Miratimin e Teksteve Mësimore për Diasporën zhvilloi mbledhjen e dytë në Prishtinë më qëllim planifikimin e punës për shpalljen e konkursit për hartimin dhe miratimin e teksteve mësimore për Diasporën.

Në përfundim të këtij takimi komisioni vendosi që brenda vitit 2019 të shpallë konkursin për nivelin e parë për tekste mësimore të përbashkëta për Diasporën.

Deri në atë datë Komisioni do të përgatisë dokumentacionin për shpalljen e konkursit, duke filluar nga plotësimi i standardeve për tekste për Diasporën. Komisioni hartoi dhe miratoi gjithashtu kalendarin e punës deri në miratimin përfundimtar të teksteve mësimore për Diasporën.

Komisioni i Përbashkët i Shqipërisë dhe Kosovës, i koordinuar nga Qendra e Botimeve për Diasporën, ka në përbërje të tij përfaqësues nga ministritë përgjegjëse për arsimin në Shqipëri dhe Kosovë si dhe përfaqësues të Agjencisë Kombëtare për Diasporën.



Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës mbajti mbledhjen e radhës me anëtarët e Këshillit Drejtues



Gjatë takimit u prezantua projekti i financuar nga Qeveria shqiptare "Diaspora Shkencore si një faktor ndryshimi në procesin e integritimit evropian të Shqipërisë" dhe zbatimi i tij nga Fondi Shqiptar për Zhvillimin e Diasporës. Në mbledhje u prezantua edhe anëtarja më e re e Këshillit znj. Anila Hyka Smorgrav si përfaqësuese e Këshillit Koordinues të Diasporës. Në takimin e sotëm u diskutuan gjithashtu edhe aktivitetet që do të kryhen gjatë vitit 2019.

Ceremoni e veçantë në Kanada për "Ambasadorët e Kombit"



Gjatë ceremonisë së ndarjes së çmimeve "Ambasador i Kombit" nga Ambasada Shqiptare në Kanada. Çmimet e akorduara personaliteteve të komunitetit shqiptar në Kanada gjatë Samitin e Dytë të Diasporës u ndanë në ceremoninë festive "Welcoming Ottawa Week".

Në Karakurt gjatë mësimave të valleve tradicionale me valltarët e Ansamblit Kombëtar Shqiptar



Vazhdojnë klasat e mësimit të valleve shqiptare në Karakurt, Ukrainë. Fëmijët e komunitetit shqiptar do të kenë mundësi që për dhjetë ditët në vijim të mësojnë kërcime tradicionale shqiptare nga valltarët profesionistë të Ansamblit Kombëtar Shqiptar. Ky cikël mësimesh është pjesë e marrëveshjes midis Agjencisë Kombëtare të Diasporës dhe Teatrit Kombëtar të Operas dhe Baletit të Shqipërisë.

"Kërkimi Shkencor në Hapësirën Mbarëshqiptare" aplikimet deri më 15 korrik



Studiuesit shqiptarë të të gjitha disiplinave nga rajoni dhe Diaspora njoftohen se afati për plotësimin e aplikimeve do të jetë deri më datë 15 korrik 2019. Brenda kësaj date të interesuarit mund të dërgojnë përmbljedhjet e temave të tyre në adresën elektronike: takimi2019@alb-shkenca.org Përpunimi i përmbljedhjeve do të bëhet deri në datën 31 korrik 2019, ndërsa vlerësimi i materialeve të dërguara dhe shpallja e punimeve të miratuara do të bëhet deri më 15 gusht 2019.

KKD, Britani

Endri Habillari u vendos në Britaninë e Madhe 17 vite më parë për të studiuar menaxhim, ndërsa sot është një anëtar aktiv në komunitetin shqiptar dhe në shoqërinë Britanike. Ai ka kandiduar në zgjedhjet lokale në Partinë Laburiste dhe aktualisht është anëtar i këshillit Koordinues të Diasporës.

KKD, Kanada

Gjatë ceremonisë së mbylljes së vitit shkollor në shkollën shqipe "Foleja e Shqiponjave", në Calgary, Kanada. Anëtarja e Këshillit Koordinues të Diasporës dhe mësuese e gjuhës shqipe në këtë shkollë, Adriana Fishta Bejko u dorëzon nxënësve certifikatat e përfundimit të klasës së gjuhës shqipe.

KKD, Itali

Rosario Petta është përfaqësues i arbëreshëve, anëtar i Këshillit Koordinues të Diasporës e njëherësh edhe kryetar i Komunitetit "Piana Degli Albanesi" në Itali. Në një intervistë të gjatë ai rrefën për aktivitetin në komunitetin arbëresh dhe mesazhin e tij për gjithë shqiptarët: "Një shqiptar kurrsesi nuk mundet të harrojë se ndajmë "një gjak, një gjuhë, një botë".